

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ 31/2010

Data: 01 Nëntor 2010

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Lars Dahlstedt dhe Harri Katara dhe Gjyqtarët e Kosovës Salih Toplica e Marije Ademi si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufit Këshilltar Ligjor i EULEX-it, si procesmbajtës,

Në lëndën penale P nr 628/04, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurit Jeton Kiqina, me të dhëna tjera si në shkresat e lëndës, të akuzuar për Vrasje, në kundërshtim të nenit 30 par 2, pika 1,3,4 dhe 5 e Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, (*tash e tutje* “KP KSAK”) lidhur me nenin 22 dhe 24 të Kodit Penal të Ish Republikës së Jugosllavisë (*tash e tutje* “KP RSFJ”); Vrasje në tentativë, në kundërshtim të nenit 30 par 2, pika 1,3,4 dhe 5 të KP KSAK-së, lidhur me nenin 19, 22 dhe 24 të KP RSFJ-së; Marrëveshje për të kryer një vepër penale, në kundërshtim të nenit 196 të KP KSAK-së lidhur me nenin 22 dhe 24 të KP RSFJ-së; sipas Aktakuzës PP nr 523/02 të paraqitur më 14 dhjetor 2004 dhe më pas të ndryshuar me Aktakuzën shtesë PP nr 526/02 të datës 31 Janar 2005,


Duke vendosur mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës, Avokat Ibrahim Dobruna, në emër të të pandehurit Jeton Kiqina, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P nr 628/04, të datës 08 mars 2007 dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP-Kz nr 84/09, të datës 03 dhjetor 2009,

Në përputhje me nenin 454 paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale i Kosovës (*tash e tutje* “KPPPK¹”), pa seancës së këshillimit dhe pas votimit të mbajtur më 01 Nëntor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. **Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, e datës 04 mars 2010 e paraqitur nga avokati mbrojtës, Av Ibrahim Dobruna, në emër të të pandehurit Jeton Kiqina, kundër Aktgjykimit (P nr 628/04, të datës 08 mars 2007) të lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës dhe kundër Aktgjykimit (Ap-Kz nr 84/09, të datës 03 dhjetor 2009) të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 456 të KPPPK-së.**

¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës ka hyri në fuqi më 06 prill 2004, i ndryshuar me vonë.



ARSYETIMI

I. Historia e Procedurës

Aktakuza pretendon se më 20 Gusht 2001, në orën apo rreth orës 23. 17 Hamëz Hajra, bashkëshortja e tij Miradije, i biri i rij Xhevdeti dhe të bijat e tij Mimoza e Adelina ishin vrarë në një rrugë të vogël zhavorri në mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik. Ata më herët kishin marrë pjesë në një dasmë të një anëtarit të familjes në fshatin Baicë. Duke u larguar nga dasma, familja Hajra udhëtonte në një veturë, të vozitur nga Xhevdet Hajra, me Hamzën në ulësen e bashkudhëtarit dhe me bashkëshorten e tij dhe vajzat e tij në ulëset e pasme duke shkuar në drejtim të shtëpisë së tyre në Gllogovc. Gjersa vetura ishte duke kaluar ngadalë një urë të vjetër druri vajza Pranvera dëgjoi një zë në Shqip duke bërë titur "ndal" dhe pastaj një zhurmë nga arma automatike. Plumbat filluan të qellonin veturën dhe Pranvera uli kokën e saj poshtë në prehrin e saj dhe qëndroi ashtu. Të gjitha dritaret e veturës, përveç njërës, ishin qëlluar dhe kishte shumë vrima të fishekëve në anën e djathtë të veturës. Hamëz Hajra, bashkëshortja e tij, i biri i tij dhe dy vajzat e tij vdiqën si pasojë e plagëve nga armët e zjarrit; Pranvera mbeti gjallë.

Hetimet kundër Jeton Kiqinës dhe të tjerëve lidhur me këtë incident kishin filluar më 09 Korrik 2002 dhe ishin zhvilluar gjersa i pandehuri Jeton Kiqina ishte në arrati. I pandehuri Jeton Kiqina u arrestua më 09 Nëntor 2004 me urdhër arresti të lëshuar me parë të datës 11 Korrik 2002. Paraburgimi i të pandehurit Jeton Kiqina që prej asaj kohe është rishikuar dhe është vazhduar periodikisht.

Më 10 Nëntor 2004 gjyqtari hetues lëshoi një vendim për vazhdimin e hetimeve kundër Jeton Kiqinës me dyshimin për bashkëpunim në vrasjen e Hamëz Hajrës dhe katër anëtarëve të familjes së tij, vrasjen në tentativë të Pranvera Hajrës, dhe marrëveshje për të kryer vepër penale.

Hetimet kundër Jeton Kiqinës kanë përfunduar më 10 Dhjetor 2004. Aktakuza e cila ishte paraqitur më 14 dhjetor 2004 dhe aktakuza shtesë e datës 31 Janar 2005 ishte konfirmuar nga Gjykata e Qarkut më 31 Mars 2005. Gjykimi i të pandehurit Jeton Kiqina filloi më 29 Qershor 2005.

Më 08 Mars 2007 pas përfundimit të gjyqimit, i pandehuri u shpall fajtor nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për kryerje të veprave penale; **Vrasje**, sipas nenit 30 par 2, pika 1,3,4 dhe 5 e KP KSAK-së lidhur me nenin 22 dhe 24 të KP RSFJ-së; **Vrasje në tentativë**, sipas nenit 30 par 2, pika 1,3,4 dhe 5 të KP KSAK-së, lidhur me nenin 19, 22 dhe 24 të KP RSFJ-së; **Marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes**, sipas nenit 196 të KP KSAK-së lidhur me nenin 22 dhe 24 të KP RSFJ-së, dhe u dënua me dënim unik me 16 vjet burgim.

Avokati mbrojtës paraqiti ankesë brenda afatit ligjor kundër aktgjyqimit duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, shkelje të kodit penal dhe dënimit të rëndë jo-proporcional. Ankuesi kërkoi lirim nga të gjitha akuzat ose anulim të aktgjyqimit dhe kërkoi që lenda të rigjykohej.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës në mendimin e tij të datës 02 Shtator.2009 propozoi që ankesa e avokatit mbrojtës të pranohet pjesërisht; duke kërkuar ndryshim të pjesshëm të aktgjykimit të kundërshtuar duke ri-cilësuar veprat penale të Vrasjes dhe Vrasjes në tentativë dhe liruar të pandehurin nga akuza për Marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes.

Më 03 Dhjetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës pranoi pjesërisht ankesën e avokatit mbrojtës; i pandehuri Jeton Kiqina u lirua nga vepra penale Marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes, nga neni 196 të KP KSAK-së lidhur me nenin 22 dhe 24 të KP RSFJ-së. I pandehuri Jeton Kiqina megjithatë u shpall fajtor për pesë Vrasje të rënda me dashje dhe një Vrasje të rëndë me dashje në tentativë nga neni 30 par 1 dhe 2 pika 1 dhe par 3 i KP KSAK-së lidhur me nenin 19 dhe 22 të KP RSFJ-së, dhe u dënua me dënim unik me 16 vjet burgim.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës iu dorëzua të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës më 30 Dhjetor 2009 përkatësisht më 06 Janar 2010.

Më 04 Mars 2010 avokati mbrojtës Av Ibrahim Dobruna në emër të të pandehurit Jeton Kiqina paraqiti një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Avokati mbrojtës kërkoj ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara; lirimin e të pandehurit nga të gjitha pretendimet penale, kthimin e çështjes për rivendosje në gjykatën e shkallës së parë dhe në fund ndërprerjen e paraburgimit.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte përcjellë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 31 Mars 2010. Lënda ishte dërguar në ZPSK për mendim.


Me anë të parashtresës KMLP 2/2010 të datës 21 Qershor 2010 Zyra e Prokurorit të Shtetit paraqiti një përgjigje dhe propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

II. Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë;

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Av Ibrahim Dobruna pretendon Shkelje të Ligjit Penal, Shkelje Esenciale të Ligjit të Procedurës Penale, Shkelje tjera të Dispozitave të Ligjit të Procedurës Penale (që ndikuan në ligjshmërinë e vendimit të gjykatës).

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Duke vlerësuar Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës e vërtetoi siç vijon:



a. Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është parashtruar në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 454 par 1 dhe brenda afatit kohor në pajtim me nenin 452 par 3 të KPPPK-së.

b. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancë siç është paraparë me nenin 454 paragrafit 1 të KPPPK-së. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk është i domosdoshëm.

c. Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pabazuar.

Avokati mbrojtës pretendoi një numër të shkeljeve prej të cilave disa edhe pse të cilësuar prej ankuesit si shkelje të ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale, në të vërtetë më tepër ka të bëjë me gjendjen faktike (vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve). Megjithatë, kjo gjykatë në vlerësimin e saj është kufizuar nga neni 451 dhe 455 të KPPPK-së në lidhje me bazat e kërkesës dhe argumentet e ngritura nga pala kërkuese.

Vlen të përmendet që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kryesisht ka të bëjë me çështjet që tanimë janë ngritur dhe trajtuar gjatë procedurës ankimore me ndryshime minimale të adoptuara kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Supreme në shkallën e dytë.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë avokati mbrojtës pretendon si në vijim:

A. SHKELJE SUBSTANCIALE TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE DHE TË SHKELJE TJERA TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE.

1. PËRBËRJA JO E DUHUR E KOLEGJIT TË SHKALLËS SË PARË


Avokati mbrojtës pretendon për përbërje jo të drejtë të trupit gjykues pasi që është përbërë prej tre në vend të pesë gjyqtarëve (kolegj i vogël). Përveç kësaj mbrojtja argumenton se zëvendësimi i anëtarëve të kolegjtit në seancën e fundit të mbajtur me 8 Mars 2007 ka shkelur nenin 364, par 1, pikën 1 të Ligjit të Procedurës Penale (tash e tutje "LPP²"), dhe nenin 403, par 1, pikës 1 të KPPPK-së.

Duke i adresuar pretendimet ankimore lidhur me përbërjen e trupit gjykues, Gjykata Supreme pajtohet me avokatin mbrojtës që KPPPK-ja parasheh kolegj më të gjerë të përbërë prej pesë anëtarëve (dy gjyqtarëve profesional dhe tre gjyqtarëve porotë) kur merren me veprat penale të dënueshme me më së paku pesëmbëdhjetë vite burgim. Lidhur me këtë në mënyrë specifike neni 24 i KPPPK-së thotë:

(1) Gjykata Supreme e Kosovës gjykon në kolegj të përbërë nga tre gjyqtarë, ndërsa kur gjykon vepra më të rënda penale të dënueshme me të paktën pesëmbëdhjetë vjet burgim, në kolegj të përbërë nga dy gjyqtarë dhe tre gjyqtarë porotë.

Në këtë kontekst si parim ligjor është e padiskutueshme që kolegji më i gjerë është i nevojshëm në rastet e dënueshme me së paku pesëmbëdhjetë vjet.

² Ligji mbi Procedurën Penale, Gazeta Zyrtare nr. 26/86



Megjithatë vlen të përmendet që derisa neni 24 i KPPPK-së i parasheh rregullat mbi përbërjen e kolegjit, emërimi dhe caktimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë rregullohet me dispozitave tjera ligjore. Gjykata Supreme thekson se caktimi i gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtar në lëndët penale është bërë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/06 të datës 15 dhjetor 2000³. Sikurse edhe në lëndët tjera penale të trajtuar nga gjyqtarët ndërkombëtarë përbërja e trupit gjykues në këtë lëndë është bërë në pajtim dhe në përputhje të plotë me rregulloren e përmendur. Për më tepër nuk është kontestuese që kjo rregullore ka qenë në fuqi dhe e aplikueshme gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Në këtë kontekst posaçërisht neni 2.1 mbi Caktimin dhe Ndërrimin e Vendit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar thotë:

“Me rastin e miratimit nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 1 më lart, Departamenti i Drejtësisë menjëherë do të caktojë:

(a) një prokuror ndërkombëtar,

(b) një gjyqtar hetues ndërkombëtar dhe/ose

(c) një kolegji gjykues të përbërë vetëm nga tre (3) gjyqtarë duke përfshirë së paku dy gjyqtarë ndërkombëtarë prej të cilëve njëri do të jetë kryesues,

Gjykata Supreme është e mendimit se çështja e rregullimit të dyfishtë në mes të dispozitave të KPPPK-së dhe Rregulloreve të UNMIK-ut të cituara më lart duhet të zgjidhet sipas parimit të specialitetit, d.m.th.: neni 2.1 pika (c) në mënyrë të veçantë duke adresuar caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në lëndët penale, si një akt special është mbi (me prioritare) ndaj dispozites së KPPPK-së e cila në mënyrë të gjerë e adreson përbërjen e trupave gjykues.

Prandaj, Gjykata Supreme e konsideron kërkesën e mbrojtjes të pabazuar në këtë pikë.

Sa i përket ndërrimit të përbërjes së trupit gjykues, neni 345 paragrafi 1 të KPPPK-së përcakton si në vijim:

“Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e fillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbalit i këqyrjes së vendit”.

Duke e adresuar pohimin e mbrojtjes ndaj ndërrimit të përbërjes së kolegjit, Gjykata Supreme i referohet procesverbalit të gjykimit të datës 20 shkurt 2007 e cila në mënyrë të

³ Shih Rregulloren e Misionit të Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara nr. 2000/6 të datës 12 shkurt 2000, e ndryshuar me Rregulloren nr. 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000.

qartë tregon se kryetari i kolegjit ka lajmëruar ndërrimet në përbërjen e trupit gjykues. Në mënyrë të dukshme palët në procedurë duke përfshirë avokatin mbrojtës edhe pasi që në mënyrë specifike janë pyetur nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e re të kolegjit dhe të gjitha palët janë pajtuar që të lexohen dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor. Faktikisht, Gjykata Supreme e konsideron të rëndësishme të theksojë se është pikërisht avokati mbrojtës i cili ka deklaruar që nuk ka kurrfarë vërejtje në formimin e trupit të ri gjykues; ka deklaruar se ai pajtohet me leximin e deklaratave të mëparshme me qëllim të përsheptimit dhe shmangies së vonesave procedurale. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se vetë fakti që ka ndodhur ndërrimi i përbërjes së kolegjit nuk do të thotë *eo ipso* që kolegji i ri ka qenë në kundërshtim me ligjin. Për më tepër asnjë rrethanë që do të mund të bëjë paanësinë e anëtarëve të ri të kolegjit të Gjykatës së Qarkut të dyshimtë nuk është gjetur në këtë lëndë.

Prandaj, Gjykata Supreme konsideron kërkesën e mbrojtjes të pabazuar në këtë pikë.

2. PAKUPTUESHMËRIA E DISPOZITIVIT TË AKTGJYKIMEVE TË SHKALLËS SË PARË DHE DYTË.

Ankuesi pohon se dispozitivet e aktgjykimeve të kundërshtuara të lëshuara në shkallën e parë dhe të dytë janë të pakuptueshme, të parregullta në brendi apo të papajtueshme me bazat e aktgjykimit dhe nuk i kanë cituar arsyet që kanë të bëjnë me faktet vendimtare; në veçanti dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimeve është kontradiktor me deklaratat e të akuzuarve, dëshmitarëve, dëshmitarëve të akuzuar, dokumentacionit tjetër në shkresat e lëndës dhe përtej kapacitetit të dëshmimeve të administruara dhe këto aktgjykime nuk kanë specifikuar se çfarë lloji të fajësisë i është atribuar të akuzuarve.


Gjykata Supreme me respekt të plotë nuk pajtohet me avokatin mbrojtës dhe e konsideron pohimin e avokatit mbrojtës si të pabazuar.

Sipas nenit 396 paragrafit 1 të KPPPK-së, aktgjykimi duhet të ketë pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin. Përmbajtja e obligueshme e dispozitivit është specifikuar më tutje në nenin 396 paragrafët (3), (4) dhe (5) të KPPPK-së.

Në lidhje me përmbajtjen e dispozitivit të aktgjykimit, neni 396 paragrafi 3 i KPPPK-së thotë:

(3) Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuzat për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuzat.

(4) Kur i akuzuari është dënues, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuzat ose akuzat është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale me kërkesën pasurore juridike nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.



Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar që është lëshuar në gjykatën e shkallës së dytë, është në tërësi në pajtim me dispozitat e ligjit procedural në fuqi. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban të cituara fakte dhe rrethana të cilat përbëjnë figuren e veprës penale dhe ato mbi të cilat varet zbatimi i dispozitës së caktuar të ligjit penal, përderisa faktet dhe rrethanat mbi të cilat gjykata nxjerr përfundimet e saj lidhur me fajësinë e të akuzuarit për veprën penale nuk duhet të përfshihen në dispozitiv, por duhet të adresohen në arsyetimin e aktgjykimit. Aktgjykimi në mënyrë të qartë në dispozitiv thotë se i akuzuari shpallet fajtor për veprën penale të pesë vrasjeve të rënda të qëllimshme dhe një vrasje të rëndë të qëllimshme në tentativë, të kryera në mënyrë dinake. Në arsyetim po ashtu gjykata ka shteruar të gjitha arsyet duke treguar pse kishte vendosur që i akuzuari kishte vepruar qëllimisht duke pasur si qëllim vrasjen e viktimave. Në përputhje me këtë, Gjykata Supreme është e mendimit se pretendimi i mbrojtjes lidhur me shkeljen e ligjit procedural është jomeritor.

Përveç kësaj, vërejmë se dispozitivi i aktgjykimit iu referohet dispozitave të ligjit penal, duke qartësuar se cilën formë të fajësisë e ka përcaktuar gjykata. Për këtë arsye, përderisa ankuesi mund të vë në pyetje nëse ky atribut është i mbështetur në dëshmi apo jo, vendimet e gjykatës mbeten të qarta dhe të lira nga gabimet sipas Nenit 396 të KPPPK-së.

3. AKTGJYKIMI ËSHTË MBËSHTETUR NË DËSHMI TË PAPRANUESHME – LIRIMI I ANËTARËVE TË FAMILJES KIQINA NGA OBLIGIMI PËR TË DËSHMUAR PARA GJYKATËS

Avokati mbrojtës pretendon se i akuzuari Florim Kiqina është marrë në pyetje si dëshmitar sikur edhe Jeton Kiqina dhe Blerim Kiqina. Avokati mbrojtës pohon se ata janë familjarë dhe se sipas Nenit 227 të LPP-së ata është dashur që të lirohen nga obligimi për të dëshmuar. Avokati mbrojtës pohon se këta individë nuk janë udhëzuar me kohë para se të japin dëshmitë e tyre në përputhje me Nenin 227, paragrafi (1) (2) dhe (4), Neni 229 dhe Neni 231 par (2) i LPP-së dhe/ose Neni 160 paragrafi 3 dhe Neni 161 paragrafi 1 pika 2 e KPPPK-së.


Para se t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, Gjykata Supreme konsideron shumë të rëndësishme të theksojë se ligji procedural në fuqi në kohën e marrjes së këtyre deklaratave ka qenë Ligji mbi Procedurën Penale (LPP). Në këtë lëndë penale nuk kontestohet aplikimi i LPP-së gjatë fazës hetimore.

Në këtë kuptim Neni 227 (1) i LPP-së i numëron personat të cilët janë të liruar nga detyra për të dëshmuar.

Në pjesën përkatëse të LPP-së shkruan si më poshtë:

(1) *Janë liruar nga detyra e dëshmimit: :*

1) *Bashkëshorti i të pandehurit;*



- 2) *Personat e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë të të pandehurit, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore përfundimisht deri në shkallën e tretë, si dhe personat e gjinisë së krushqisë përfundimisht deri në shkallë të dytë;*
- 3) *I adoptuari dhe adoptuesi i të pandehurit;*
- 4) *Personi fetar mbi atë çka i pandehuri i është rrëfyer.*

Siç është shpjeguar edhe nga avokati mbrojtës, i akuzuari Florim Kiqina dhe Arben Kiqina janë vëllezër. E njëjta vlen edhe për Burim Ramadanin dhe Arsim Ramadanin. I akuzuari Blerim Kiqina është djali i axhës së Florim Kiqinës, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës. Adem Kiqina është axha i Jeton Kiqinës. Xhevdet Kiqina dhe Adem Kiqina janë vëllezër. Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina janë djem të axhës së Xhevdet Kiqinës. Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina janë djem të axhës së Jeton Kiqinës.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike del se Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina janë të afërt në vijën anësore të shkallës së katërt me të pandehurin Jeton Kiqina. Si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykatat e shkallëve të mëhershme kanë konstatuar në mënyrë të saktë se organet e ndjekjes gjatë zhvillimit të intervistave kanë vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit të procedurës që ka qenë në fuqi atëherë.

Është evidente nga shkresat e lëndës se Florim Kiqina është dëgjuar si dëshmitar më 27 Gusht 2001 kur është njoftuar se ka të drejtë të heshtë. Më vonë, më 6 Korrik 2002 Florim Kiqina është dëgjuar si i dyshuar dhe është njoftuar mbi të drejtat e të dyshuarit. Kjo konfirmohet përmes një dokumenti që ai e kishte nënshkruar në fund. Sa i përket marrjes në pyetje më 7 Korrik 2002, avokati i tij mbrojtës ka qenë i pranishëm kur i është marrë deklarata.

Prandaj, pranimi i këtyre dëshmimeve nuk ngre dyshime lidhur me pranueshmërinë formale dhe besueshmërinë e tyre. Në pajtim me këtë, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa e mbrojtjes lidhur me këtë pikë është e pabazë.

4. PRANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË BLERIM KIQINËS MË 4 DHE 7 KORRIK 2002

Avokati mbrojtës pohon se të dy deklaratat e dhëna nga Blerim Kiqina më 4 dhe më 7 Korrik 2002 janë të papranueshme. Avokati mbrojtës thotë se deklarata e dhënë në polici më datën 4 Korrik 2002 e cila edhe është regjistruar në video, është dhënë pa praninë e avokatit mbrojtës dhe pa autorizimin e gjykatës. Për më tepër, avokati mbrojtës pretendon se avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare i cili ka qenë i pranishëm më 7 Korrik 2002 nuk e ka mbrojtur klientin e vet në mënyrë efikase; sepse ky avokat nuk ka bërë asnjë pyetje as nuk është konsultuar fare me klientin e vet para intervistimit të tij. Për këtë arsye, sipas mbrojtjes, këto deklarata janë të papranueshme.

Lidhur me deklaratën e datës 4 Korrik 2002, Gjykata Supreme pajtohet me pretendimin e ankuesit. Siç është theksuar nga gjykata e shkallës së dytë, në shkresat e lëndës nuk janë gjetur të dhëna që dokumentojnë se Blerim Kiqina është njoftuar ashtu si duhet mbi të

drejtat e veta para dhënies së deklaratës. Gjykata Supreme pranon natyrën obligative të Nenit 67, paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së, i cili parasheh që ... "i akuzuari duhet të udhëzohet se ka të drejtë të angazhojë avokatin mbrojtës dhe që mbrojtësi mund të merr pjesë në marrjen në pyetje".

Udhëzimet lidhur me të drejtat e siguruara në mënyrë jo të kënaqshme dhe/ose paaftësinë e organeve që kanë zhvilluar intervistën për të dokumentuar që i intervistuari është njoftuar në mënyrë të duhur mbi të drejtat e veta, e bëjnë deklaratën të papranueshme. Për këtë arsye, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së dytë duke vendosur mbi ankesën ka bërë vlerësimin e duhur që deklarata e Blerim Kiqinës e dhënë para policisë më 4 Korrik 2002 është e papranueshme.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme pajtohet me pretendimin e mbrojtjes së video-regjistrimi i deklaratës më datën 4 Korrik 2002 ka qenë në shkelje të ligjit të procedurës.

Neni 87 par 1 i LPP-së përcakton;

(1) Gjyqtari hetues mund të urdhërojë që procedura e marrjes në pyetje të regjistrohet në shirit të magnetofonit. Gjyqtari hetues në mënyrë paraprake e njofton personin i cili merret në pyetje apo dëgjohet, lidhur me këtë gjë.

Duke u bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Supreme konstaton se i vetmi organ legjitim i cili lejon regjistrimin e intervistës është gjyqtari hetues. Mosrespektimi i kësaj dispozite përbën shkelje procedurale.

Në rastin në fjalë, nuk ka të dhëna në shkresat e lëndës të cilat dëshmojnë se video-regjistrimi është autorizuar nga ana e gjyqtarit hetues. Si duket, policët që kanë kryer marrjen në pyetje kishin njoftuar një prokuror ndërkombëtar sapo kishin marrë vesh cilësinë e kësaj deklarate e cila ndikonte në cilësinë juridike të të intervistuarit. Megjithatë, nuk mund të tërhiqet asnjë përfundim se video-regjistrimi është autorizuar nga organi legjitim. Ky kolegji me gjithë respektin, nuk pajtohet me pikëpamjen e Gjykatës Supreme që vendos mbi ankesën sipas së cilës intervista ishte regjistruar me kërkesë të prokurorit, në pajtim me kompetencat e tij për zhvillimin e procedurës penale paraprake, sepse në atë moment gjyqtari hetues nuk ka qenë akoma i kyçur në atë fazë të hetimeve. Ky kolegji konsideron se fakti që nuk ka qenë i kyçur asnjë gjyqtar hetues në atë fazë të hetimeve nuk ia heq kompetencat gjyqtarit hetues në ndjekjen penale⁴. Nuk mund të ketë bartje të këtyllë të kompetencave e cila shkon në dëm të të pandehurit. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme konsideron se prokurori ka tejkaluar autorizimet e veta me ndërmarrjen e veprimeve të tilla. Për këtë qëllim, Gjykata Supreme konsideron se video-regjistrimi nuk është bërë në përputhje me procedurën, prandaj si i tillë, i njëjti duhet të veçohet nga shkresat e lëndës.

Lidhur me deklaratën e datës 7 korrik 2002 të cilën mbrojtja e argumenton se avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk e ka mbrojtur klientin e tij në mënyrë efektive, avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare nuk ka i bërë asnjë pyetje të pandehurit, se ai nuk

⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Ap.-Kz Nr. 84/2009, i datës 3 dhjetor 2009, faqe 19, pika 38.

ishite konsultuar me klientin e tij para intervistës së tij, Gjykata Supreme e konsideron këtë argument si të pabazuar.

Gjykata pranon rolin e rëndësishëm fundamental të cilin e luajnë avokatët mbrojtës në procedurat penale. Gjithashtu pranon se caktimi i avokatit mbrojtës sipas detyrës zyrtare nuk është vetëm kusht formal i kufizuar vetëm me praninë e avokatit mbrojtës. Përkundrazi, avokati është i obliguar që jo vetëm të jetë i pranishëm por t'i kryejë detyrat me përgjegjësi, me ndershmëri, respekt dhe të mbrojë interesat e klientit të tij/saj sipas standardeve më të larta profesionale dhe në pajtueshmëri me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Sipas nenit 67 paragrafit 1 të LPP-së:

“I pandehuri mund të ketë mbrojtësin gjatë tërë procedurës penale”.

Ky nen duhet të interpretohet në atë mënyrë që gjithashtu të përfshijë fazën e hetimeve *“Nëse procedura penale është duke kaluar nëpër fazën e hetimeve atëherë iniciohet nga momenti kur lëshohet vendimi për zhvillimin e hetimeve”.*⁵

Më tutje, lidhur me këtë pikë neni 72 (4) i LPP-së thotë:

“Kryetari i gjykatës, në bazë të kërkesë të të pandehurit ose me pëlqimin e tij, mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk ushtron rregullisht detyrën. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës do të caktojë një mbrojtës tjetër të pavarur me përvojë dhe kompetenca në përputhshmëri me natyrën veprës penale në fjalë. Mbi shkarkimin e mbrojtësit i cili është anëtar i dhomës do të njoftohet Dhoma e avokatisë”.

Në bazë të kësaj, i pandehuri ka të drejtë në avokat mbrojtës gjatë tërë procedurës penale. Mospërmbyshja e kushteve të tilla shkel të drejtat e të pandehurit në avokat mbrojtës efektiv. Ligji parasheh që kryetari i gjykatës mund ta shkarkojë një avokat mbrojtës të caktuar i cili nuk i kryen detyrat e tij/saj si duhet në bazë të kërkesë të të pandehurit ose me pëlqimin e tij/saj.

Në këtë lëndë, sidoqoftë nuk mund të gjendet asnjë shkelje e të drejtave për mbrojtje efektive. Në bazë të shkresave të lëndës, nuk mund të gjendet asnjë kërkesë nga i pandehuri apo dikush tjetër me pëlqimin e të pandehurit lidhur me pakënaqësinë me kryerjen e detyrave nga ana e avokatit mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare. Fakti që avokati mbrojtës i caktuar më parë i cili ka marrë pjesë në fazat e mëparshme të procedurës i cili më vonë është zëvendësuar në fazën e gjykimit nga avokati mbrojtës i tanishëm, në mendimin e Gjykatës Supreme nuk e aktivizon mbrojtjen e ofruar nga neni 72 i LPP-së. Avokati mbrojtës nuk ka treguar se si të drejtat e klientit të tij për mbrojtjen efektive janë ndikuar në mënyrë të pafavorshme. Gjykata Supreme nuk ka gjetur asnjë rrethanë e cila do ta bënte sjelljen e avokatit mbrojtës të mëparshëm të caktuar sipas detyrës zyrtare si të dyshimtë në këtë lëndë. Prandaj, Gjykata Supreme nuk ka gjetur

⁵ Komentari i Momcillo Grubac & Tihomir Vasiljevic. Versioni në gjuhën angleze.

asnjë shkelje të të drejtave të mbrojtjes të cilat i garantohen të pandehurit sipas ligjit të aplikueshëm.

Është evidente që të pandehurit dhe avokati të tij mbrojtës i janë ofruar mundësi të shumta për tu deklaruar për lëndën dhe për ta kontestuar zbatimin e ligjit për dëshmitë para gjykatës. Vetë fakti që avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk ka bërë asnjë pyetje siç pretendohet nga ankuesi, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk shpie në përfundim të arsyeshëm se avokati mbrojtës ka vepruar në dëm të klientit të tij. Nuk është në gjykatën e shkallës së parë që ta përcaktojë strategjinë e mbrojtjes. Avokati mbrojtës është palë në procedurë; i lirë dhe i pavarur në ushtrimin efektiv të funksioneve të avokatit mbrojtës.

Gjykata Supreme nuk ka gjetur asnjë dëshmi për sjellje të keqe të avokatit mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare, përfshirë dështimin në ofrimin e asistencës ligjore kompetente dhe etike. Prandaj, Gjykata Supreme e konsideron këtë pikë si të pazuar.

5. PRANUESHMËRIA E PROCESVERBALIT TË SHQYRTIMIT TË POLICIT NDËRKOMBËTAR RODNEY HYLTON DHE LISTËS SË THIRRJEVE TELEFONIKE TË TELEFONIT MOBIL.

Avokati mbrojtës pretendon papranueshmërinë e deklaratës së policit ndërkombëtar Rodney Hilton të datës 6 dhe 7 Gusht 2002. Pohohet që kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit hetues është bërë gjatë seancës dhe pasi që nuk është vendosur mbi të, sipas avokatit mbrojtës vazhdimi i seancës është në kundërshtim me ligjin në kuptim të nenit 43 të LPP-së.

Përveç kësaj, avokati mbrojtës pohon se lista e thirrjeve telefonike të telefonit mobil është marrë në mënyrë të kundërligjshme nga PTK⁶. Sipas avokatit mbrojtës nuk është bërë asnjë kërkesë nga gjyqtari hetues për të kërkuar informacione të tilla nga PTK-ja.

Lidhur me deklaratën e dhënë nga Rodney Hilton, Gjykata Supreme vlerëson se është e rëndësishme të theksohet fakti që kërkesa e avokatit mbrojtës për përjashtimin e gjyqtarit hetues nuk është bërë në fillim të seancës mirëpo gjatë seancës më 6 Gusht 2002, sipas nenit 39 paragrafit 6.

Gjykata Supreme ndan mendimin e avokatit mbrojtës se kërkesa për përjashtim mund të dorëzohet para se të filloj seanca, mirëpo nëse palët kanë mësuar arsyet për përjashtim pasi të ketë filluar seanca, ata mund të paraqesin kërkesë më vonë mirëpo menjëherë pasi që t'i kenë mësuar ato.

Neni 40 (1) i LPP-së thotë:

(1) Gjyqtari ose ndihmësgjyqtari, porsa mëson se ekziston ndonjëri nga shkaqet për përjashtimin nga neni 39 pika 1 deri 5 të këtij ligji, ka për detyrë të ndërpresë çdo veprim në atë lëndë, dhe për këtë gjë të njoftojë kryetarin e gjykatës, i cili do t'i caktojë

⁶ PTK-ja- Posta dhe Telekomit Kosovës.

zëvendësin. Kur është fjala mbi përjashtimin e kryetarit të gjykatës, ai do t'i caktoj vetës zëvendësin midis gjyqtarëve të asaj gjykate, e kur kjo gjë nuk është e mundur, do të kërkojë nga kryetari i gjykatës së drejtpërdrejt më të lartë që të caktojë zëvendësin.

(2) Kur gjyqtari ose ndihmësgjyqtari konsiderojnë se ekzistojnë rrethana të tjera të cilat justifikojnë përjashtimin e tij (neni 39 pika 6) do të njoftojë për këtë gjë kryetarin e gjykatës.

Neni 43 i LPP-së thotë:

Kur gjyqtari ose ndihmësgjyqtari mëson se është bërë kërkesa për përjashtimin e tij, ka për detyrë që menjëherë të pezullojë çdo veprim në lëndë, e kur është fjala për përjashtimin nga neni 39 pika 6 e këtij ligji, deri në nxjerrjen e aktvendimit mbi kërkesën, mund të ndërmarr vetëm ato veprime për të cilat ekziston rreziku nga shyrja.


Neni 39 i LPP-së thotë:

Gjyqtari ose ndihmësgjyqtari nuk mund të ushtojë detyrat gjyqësore:

- 1)
- 2).....
- 3).....
- 4).....
- 5).....

(6) kur ekzistojnë rrethana të cilat shkaktojnë dyshim në objektivitetin e tij.

Gjykata Supreme është e mendimit që kërkesa për përjashtim e bërë mbi bazën e përcaktuar në nenin 39 paragrafin 6 të LPP-së nuk e bënë të domosdoshme ndërprerjen e përfundimit të një aktiviteti ligjor në zhvillim e sipër i cili ka filluar para paraqitjes së një kërkesë të tillë. Neni 40 paragrafi 2 i LPP-së në mënyrë specifike përcakton obligimet e gjyqtarit ose gjyqtarit laik përjashtimi i të cilit është kërkuar vetëm për ta njoftuar kryetarin e gjykatës nëse ai/ajo mendojnë se ekzistojnë rrethana që arsyetojnë përjashtimin e tij sipas nenit 39 pikës 6. Kjo, specifikohet më tutje në nenin 43 të LPP-së i cili parasheh se nëse kërkesa ka të bëjë me përjashtimin nga neni 39 paragrafi 6, për çka edhe bëhet fjalë në këtë rast, gjyqtari apo gjyqtari laik përjashtimi i të cilit është kërkuar mund t'i ndërmarr vetëm ato veprime të cilat janë të domosdoshme për t'iu shmangur shyrjes. Në këtë lëndë, duke iu referuar procesverbalit të datës 6 Gusht 2002 para fillimit të seancës, gjyqtari hetues ka caktuar seancën me kohë, përderisa asnjëra palë nuk ka pasur ndonjë kundërshtim, në veçanti lidhur me përjashtimin e gjyqtarit hetues. Vetë fakti i ekzistimit të kërkesës së refuzuar për përjashtim nuk e bënë deklaratën e marrë nga gjyqtari përjashtimi i të cilit është kërkuar, të papranueshme. Është evidente që gjyqtari hetues e ka njoftuar me kohë kryetarin e gjykatës lidhur me kërkesën për përjashtim e cila pastaj është refuzuar nga kryetari i gjykatës më 11 Gusht, si e pabazuar. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se gjykata i është përmbajtur kushteve të përcaktuara ligjore.



Sa i përket listës së thirrjeve të celularit, nga shkresat e lëndës është e dukshme se letra nga gjyqtari hetues e datës 23 Nëntor 2001 ishte dërguar në Drejtorin për Çështje të Infrastrukturës dhe Komunikimit duke kërkuar detajet e thirrjeve hyrëse dhe dalje të lidhura me periudhën kohore prej 19 deri më 21 Gusht 2010 për numrat e renditur atje të VALËS. Përndryshe informata e marra me gjasë nuk do të siguroheshin me iniciativën e vet zyrtarëve të PTK. Një qëndrim i këtillë është i paarsyeshëm; si pasojë ky argument nga avokati mbrojtës nuk mund të pranohet. Siç është dhënë në përgjigjen e PTK e cila është pjesë e shkresave të lëndës, kërkesa ishte përmbushur dhe rezultatet ishin vënë në dispozicion të Gjykatës. Veprimet hetuese të këtilla, në shikim të Gjykatës Supreme ishin në përputhje të plotë me dispozitat e LPP i cili ishte në fuqi në atë kohë. Nuk është gjetur asnjë shkelje e të drejtave të njeriut si rezultat i veprimtarisë së tillë. Prandaj në këtë pikë kërkesa është e pabazuar.

6. MUNGESA E LIDHJES SHKAKORE NË MES TË VEPRIMEVE DHE PASOJËS DHE KËRKESA PËR ALIBI PARASHTRUAR NGA I PANDEHURI JETON KIQINA

Avokati mbrojtës argumenton se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsye në lidhje me faktet vendimtare sa i përket Nenit 364 par 1, pika 11 e KPP respektivisht Neni 403 par 1 dhe 12 i KPPK, me mungesë në dhënien e një arsytimi të duhur në lidhje me *Lidhjen Shkakore* në mes veprimeve dhe pasojave, *Dashjes dhe Motiveve* të pandehurit. Veç kësaj, avokati mbrojtës aludon se aktgjykimet nuk i qartësojnë rrethanat e ndërlidhura me një *Alibi* pasi që Jeton Kiqina ishte në një aheng dasme te familja e Sefedin Kiqina dhe ky fakt është i mbështetur fuqishëm, sipas avokatit mbrojtës, me një varg të deklaratave bindëse të dëshmitarëve duke përfshirë po ashtu deklaratat e dëshmitarëve të prokurorit.

Gjykata Supreme e Kosovës njofton se pohimet e avokatit mbrojtës se gjetjet e gjykatës janë në kundërshtim me dëshmitë dhe se nuk siguron arsytim të duhur për *lidhjen shkakore* në mes të veprimit vs pasojës si edhe teorisë të paraqitur mbi një *alibi* të pandehurit, në këtë fazë janë të papranueshme në pajtim me Nenin 451 të KPPPK. Pretendimet e tilla janë drejtpërdrejt të lidhura me vërtetimin e gjendjes faktike, një arsye për të cilën kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet nën dispozitat e KPPPK.

Neni përkatës 451 (2) thotë:

(2) *Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike...*

Më tutje, Neni 456 i KPPPK thotë:

Me aktgjykim, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të refuzoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar nëse kjo vërteton se shkelja e ligjit e pohuar nga pala e cila bën kërkesën nuk ekziston apo nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është ushtruar

mbi baza të vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (Neni 405 dhe Neni 451 paragrafi 2 i Ligjit të tanishëm).

Duke u bazuar në arsyet e lartë përmendura, gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në këtë pjesë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë fazë të procedurës qëndron jashtë kufijve të shqyrtimit. Prandaj për këtë pjesë është refuzuar si e papranueshme.

Në adresimin e motivit/ve të mundshme të pandehurit Jeton Kiqina për të cilën mbrojtja pohon se nuk është vërtetuar, ky kolegji ndan mendimin e Gjykatës Supreme të shkallës së dytë se motivi/et për një krim nuk është/janë pjesë e vet kimit sikurse është përkufizuar me ligj. Motivi/et mund të jetë i rëndësishëm për qëllim të përcaktimit të masave kufizuese dhe kohëzgjatjen e dënimit. Megjithatë nuk ekziston asnjë obligim ligjor për gjykatën të vërtetoj motivet që e kanë shtyre të pandehurin në kryerjen e veprës penale. Për këtë arsye kjo pikë duhet të diskutohet më tutje kur merremi me pohimet e mbrojtjes në lidhje me vendimin për dënimin.

B. SHKELJET E LIGJIT PENAL NENI 451 (1) I KPPK⁷

7. MOSRESPEKTIM I PARIMIT *IN DUBIO PRO REO*

Avokati mbrojtës pohon se gjykata nuk ka respektuar Nenin 2 (2) të KPPK – Parimin Ligjor *In dubio pro reo*. Mbrojtja qëndron në atë se po që se ka dyshim në lidhje me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për lëndën apo dyshime në lidhje me zbatimin e dispozitës të caktuar të ligjit penal, gjykata duhet të interpretoj atë në mënyrë që të jetë në favor të pandehurit.

Sa u përket dyshimeve të pohuara në lidhje me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për lëndën adresuar nga avokati mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron të rëndësishme të përsëris prapë se kontestimi i aktgjyqimit mbi baza të gjendjes faktike është i papranueshëm sipas Nenit 451 (2) të KPPK. Prandaj në këtë pjesë të diskutimit, Gjykata Supreme u referohet arsyeve të sjella më lart.

Në lidhje me aplikimin e “*ligjit më të favorshëm*”, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me avokatin mbrojtës se në çështjen e ndryshimit në ligjin të aplikueshëm në lëndën e dhënë para vendimit final, duhet të zbatohet ligji i cili është më i favorshëm për kryerësin e veprës.

Në këtë kuptim konsideratë primare duhet tu jepet masave kufizuese dhe kohëzgjatjes së dënimit sikurse parashihet me dispozitat penale – ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale dhe ligji i hyrë në fuqi para se të jepet vendimi përfundimtar. Pas një krahasimi të tillë, mund të nxirret konkluzion në lidhje me ligjin i cili është më i favorshëm për të pandehurin.

Në lëndën në fjalë, padyshim se ligji në fuqi në kohën kur veprimet penale janë kryer, është shumë më i favorshëm për të pandehurin sesa ligji i hyr në fuqi para se të jepet vendimi përfundimtar. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton kërkesën mbi këtë pikë të pabazuar deri në atë shkallë që kualifikon atë si të pavlerë.

⁷Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i hyr në fuqi më 06 Prill 2004, i ndryshuar më vonë.

8. MOSRESPEKTIMI I RREGULLAVE PËR BASHKIM TË DËNIMIT

Avokati mbrojtës pohon për mosrespektim të rregullave nga gjykatat për të shqiptuar dënim unik sikurse parashihet me Nenin 48 par 1 të KP të RSFJ që korrespondon në tërësi me Nenin 71 par 1 të KPPK. Avokati mbrojtës deklaron se gjykatat në shkallën e mëhershme nuk e kanë dënuar të pandehurin për secilën veprë e më pastaj të aplikojnë një dënim unik. Më tutje, avokati mbrojtës pohon se pas lirimimit të pandehurit nga një veprë penale, Gjykata Supreme përsëri nuk e ka zvogëluar dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë.

Sa i përket deklaramentit në lidhje me bashkimin e dënimit, është e dukshme se gjykata e shkallës së dytë pasi që ka dënuar të akuzuarin për pesë vepra penale veç e veç të vrasjes dhe një tentim vrasje e ka dënuar të akuzuarin me një dënim unik prej gjashtëmbëdhjetë (16) vitesh burgim.

I pandehuri ishte dënuar për veprën penale Vrasje me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim [Neni 38 paragrafi 1 dhe 2 i KPK në lidhje me Nenin 30 paragrafi 2 i KP KSAK dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59] dhe me gjashtë (6) vite burgim për veprën penale të Tentim Vrasje [Neni 38 paragrafi 1 dhe 2 i KPK në lidhje me Nenin 30 paragrafi 2 i KP SAPL dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 dhe Neni 65 paragrafi 2 i KPK]. Me zbatimin e Nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 pika 2 e KPK, i pandehuri Jeton Kiqina ishte dënuar me një afat unik burgimi prej gjashtëmbëdhjetë (16) vitesh. Prandaj Gjykata Supreme konsideron se gjykata e apelit ka respektuar plotësisht dispozitat e ligjit në lidhje me bashkimin e dënimit.

Sa i përket zvogëlimit të dënimit pasi që i pandehuri ishte liruar nga një veprë penale nga gjykata e apelit, Gjykata Supreme qëndron në atë se nuk është obligim për gjykatën të zvogëlojë dënimin për shkak të lirimimit të pjesshëm. Gjykata është e kufizuar vetëm me ndëshkimin maksimal.

9. CILËSIM I GABUAR I VEPRËS PENALE

Në fund avokati mbrojtës pohon se veprat penale janë cilësuar gabimisht nga trupi gjykues dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Avokati mbrojtës pohon se Jeton Kiqina nuk ka ndërmarr ndonjë veprim që përbën veprat penale Vrasje ose Tentim Vrasje e as nuk ka dashur kryerjen e këtyre veprave. Më tutje mbrojtja argumenton se nuk ka lidhje në mes të veprës dhe pasojës.

Kjo gjykatë konstaton se veprimet e të akuzuarit të përmbledhura në veprat penale për të cilat ai është shpallur fajtor bazuar në dëshmitë të cilat janë siguruar siç duhet, janë vërtetuar dhe vlerësuar nga seanca kryesore e gjykatës. Lajthitja mbi zbatimin e ligjit ishte korrigjuar siç duhet nga gjykata gjatë periudhës së procedurës së apelit. Gjykata

Supreme e Kosovës është e kënaqur me ri – cilësimin e shkallës së dytë dhe prandaj konstaton se shkalla e dytë nuk ka bërë lajthim të ligjit.

Duke pasur parasysh të lart përmendurat, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL-KZZ 31/2010, 01 Nëntor 2010

Kryetari i kolegjit:

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësi:

Adnan Isufi
Këshilltar Ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Harri Katara,
Gjyqtar i EULEX-it

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Punëtori i autorizuar
Dyazëconi madri
Marije Ademi,
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Këshillë Juridike

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (Neni 451 paragrafi (2) të KPPK).